L I G J
Nr.8268, datë 22.12.1997

PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË LIGJIN NR.8202, DATË 27.3.1997 "PËR AMNISTINË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8202, datë 27.3.1997 "Për amnistinë", bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si vijon:

"Gjithë personave që janë në ndjekje penale ose janë dënuar për kryerjen e krimeve të parashikuara nga shkronja "a" deri në shkronjën "i" të nenit 1, në rast se paraqiten vullnetarisht përpara organit procedues ose kthehen vullnetarisht në burg brenda datës 30.1.1998, u falet 1/3 e dënimit, kurse të dënuarve me burgim të përjetshëm a me vdekje dënimi u kthehet në 20 vjet burgim.

Periudha nga largimi deri në kthimin vullnetarisht në burg të atyre që nuk janë paraqitur deri në datën 12.4.1997, konsiderohet ndërprerje e vuajtjes së dënimit dhe nuk llogaritet si kohë e vuajtjes së tij".

Neni 2

Pas nenit 2 shtohet neni 2/a me këtë përmbajtje:

"Kur në zbatim të këtij ligji është e nevojshme të bëhet bashkimi i dënimeve të mbetura, me kërkesë të prokurorit ose të të interesuarit, gjykata e vendit ku vuhet dënimi cakton dënimin sipas kritereve të parashikuara në nenin 55 të Kodit Penal".

Neni 3

Pas nenit 4 shtohet neni 4/a me këtë përmbajtje:

"Personat që janë arrestuar pas datës 12.4.1997 për faktin se nuk janë kthyer vullnetarisht në vendin e vuajtjes së dënimit, përfitojnë nga ky ligj.

Veprat penale të kryera pas datës 5.4.1997 nuk amnistohen në bazë të këtij ligji".

Neni 4

Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve përcakton personat që përfitojnë nga ky ligj dhe bën përllogaritjet përkatëse sipas nenit 2. Çdo ankim lidhur me to shqyrtohet nga gjykata e vendit ku vuhet dënimi, duke respektuar rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.1978, datë 25 .12.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani